



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 maj 2012
Nr. ref.: RK241/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI114/11

Parashtruesi

Veli Kryeziu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Mlc. nr. 2/2009, të 5 prillit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Veli Kryeziu nga fshati Xërxe, Komuna e Rahovecit.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. Nr. 2/2009, i 15 prillit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit më 17 maj 2011, me të cilën është pranuar kërkesa e Prokurorit publik të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe me të cilën janë ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 338/2008 i 16 tetorit 2008 dhe ai i Gjykatës Komunale të Rahovecit C. nr. 45/2007 i 2 qershorit 2008, dhe njëkohësisht refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit me të cilën kërkonte përcaktimin e të drejtës së pronës së regjistruar si parcelë kadastrale nr. 835/3, në vendin e quajtur “Rakita”, sipas listës poseduese nr. 97 të KZ Xërxe, me sipërfaqe prej 0,57.13 ha.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Mlc. Nr. 2/2009, i 5 prillit 2011, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit, “i është shkelur e drejta e mbrojtjes së pronës, e përcaktuar me nenin 46 pika 1 e Kushtetutës së Kosovës” për shkak të mosmarrëveshjes mbi të drejtën e pronës në mes të parashtruesit dhe Komunës së Rahovecit në lidhje me përcaktimin e të drejtës në pronën e regjistruar si parcelë kadastrale nr. 835/3, në vendin e quajtur “Rakita”.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi më 11 gusht 2011, parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese informoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Komunale të Rahovecit dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, për iniciimin e procedurës së shqyrtimit të kushtetutshmërisë së vendimeve për rastin KI114/11.
7. Më 04 maj 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodriguez dhe Prof. dr. Enver Hasani, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

8. Ali Kryeziu, përndryshe babai i parashtruesit, ka qenë pronar i pronës me sipërfaqe prej 0,57.13 ha, në vendin e quajtur “Rakita”, i regjistruar në regjistrin për të drejtat e pronës së paluajtshme si ngastër kadastrale nr. 835 të KZ Xrxe. Sipërfaqja e përmendur ka qenë pronë e Ali Kryeziut derisa ai ishte gjallë, ndërkaq pas vdekjes së tij ishte pronë e djalit të tij, Veli Kryeziu.
9. Në bazë të regjistrimit të kadastrës së viti 1952, kjo sipërfaqe ka qenë e regjistruar në ngastrën kadastrale nr. 21 në emër të Ali Kryeziut.
10. Në bazë të regjistrimit ajror fotogrametrik që kishte hyrë në fuqi në vitin 1959, i ekspozuar në shikim publik në vitin 1965, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 1967, ngastra e

kontestuar ka marrë numër të ri si pjesë përbërëse a ngastrës nr. 835/1. Gjatë paraqitjes së të dhënave për shqyrtim publik të vitit 1965, çdo ngastër të cilën pronari nuk e ka regjistruar si të veten, është regjistruar si pronë shoqërore. Për pjesën e ngastrës së kontestuar nr. 835/3 si pjesë e ngastrës nr. 835/, pasi që pronari nuk është paraqitur që ta regjistrojë si pronar, Komision e ka regjistruar si pronë shoqërore në regjistrin ABC nr. 130 Xërxe, në emër të KK të Rahovecit.

11. Pas hyrjes në fuqi të kadastrit teknik, më 01.01. 1969, ngastra e kontestuar regjistrohet si pronë shoqërore e KK të Rahovecit. Ngastra nr. 835/3, me sipërfaqe prej 0.57.13 ha, mbeti me të dhëna të njëjta në listën poseduese nr. 97 KZ të Xërxes, kurse prona në emër të pronës shoqërore të KK Rahovec deri në vitin 1999, kur me dekretin nr. 1/1999 të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, sipas listës poseduese nr. 97, ndryshon emrin në pronë shtetërore të KK të Rahovecit.
12. Gjatë kohës së regjistrimit ajror fotogrametrik pronari i sipërfaqes në fjalë nuk ndodhej në shtëpi, kështu që me rastin e paraqitjes së të dhënave të regjistrimit publik nuk ka qenë në gjendje të paraqitet si pronar i pronës së kontestuar. Prandaj, prona është regjistruar si pronë shoqërore. Prona tjetër në fqinjësi të së njëjtës ngastër kadastrale, sipas regjistrimit kadastral, ka qenë e regjistruar në emër të Ali Kryeziut. Ali Kryeziu, e më vonë edhe djali i tij Veli Kryeziu sipas pohimeve të parashtruesit, nuk kanë mundur të parashikojnë se kjo pronë e kontestuar është regjistruar si pronë shoqërore, deri në ditën e inicimit të kontestit gjyqësor për përcaktimin e të drejtës në pronë.
13. Duke pasur parasysh faktin se ngastra nr. 835/3 (regjistrimet në bazë të ndryshimeve të mëvonshme kadastrale) pa asnjë bazë ligjore të përcaktuar me ligjin për përvetësimin e të drejtës pronësore, por vetëm në bazë të regjistrimit ajror fotogrametrik, i cili është bërë publik në vitin 1965, është regjistruar si pronë shoqërore ndërsa të drejtën në këtë pronë e ka pronari i saj Ali Kryeziu, kurse pas vdekjes së tij, në bazë të trashëgimisë, Veli Kryeziu – parashtruesi i kërkesës i cili kishte iniciuar procedurën gjyqësore për përcaktimin e të drejtës pronësore.
14. Nga sa u tha më lartë, parashtruesi i kërkesës ka nisur proces gjyqësor në shkallën e parë në Gjykatën Komunale të Rahovecit, i cili përcakton faktet e lartpërmendura në bazë të raportit të ekspertit të gjeodezisë, Miftar Krasniqit, dhe raportit të dëshmitarit I.K. dhe Sh. K. Në bazë të provave administrative dhe fakteve të vërtetuara, me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Rahovecit C. nr. 45/2007, të 02 qershorit 2008, është përcaktuar e drejta pronësore e Veli Kryeziut në ngastrën kadastrale nr. 835/3 KZ të Xërxes.
15. Kundër këtij Aktgjykimi të Gjykatës Komunale të Rahovecit C. nr. 45/2007, të 2 qershorit 2008, është ushtruar ankesë nga avokati publik i Komunës së Rahovecit. Duke vendosur për ankesën e avokatit publik, Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin Ac. nr. 338/2008, të 6 tetorit 2008, refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Rahovecit C. nr. 45/2007, të 2 qershorit 2008.
16. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 338/2008, të 6 tetorit 2008, Prokurori publik i Kosovës parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë. Duke vendosur për kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Mlc. nr. 2/2009, të 5 prillit 2011, pranoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të bazuar dhe në bazë të gjendjes së njëjtë faktike ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Rahovecit C. nr. 338/2008, të 6 tetorit 2008, dhe hodhi poshtë kërkesëpadinë e paditësit Veli Kryeziu me të cilën ai kërkoi përcaktimin e të drejtës në pronë të ngastrës kadastrale nr. 835/3 KZ të Xërxes. Në arsyetimin e Aktgjykimit Mlc. Nr. 2/2009, të 5 prillit 2011, Gjykata Supreme ka deklaruar si në vijim:

“Paditësi (parashtruesi i kërkesës) është i detyruar që të provojë ekzistimin e fakteve juridike në bazë të cilës fitohet apo mund të fitohet e drejta e kërkuar në pronë. Paditësi në padi dhe në seancat e mbajtura pranë gjykatës së shkallës së parë deklaroi se është pronar i pronës kontestuese në baze të trashëgimisë së paraardhësit të tyre, mirëpo nuk provon mënyrën e fitimit të pronës kontestuese e as të pasardhësit të tij. Fakti se dëshmitarët kanë deklaruar se paditësi ngastrën kontestuese e ka trashëguar nga paraardhësi i tij, nuk paraqet bazë të vlefshme juridike për vërtetimin e pronësisë së paditësit. Prona kontestuese që nga viti 1965 në librat kadastrale evidentohet në emër të paditurës (Komuna e Rahovecit) ndërkaq paditësi nuk ka dëshmuar me fakte se paraardhësi i tij dhe paditësi të kenë ndërmarrë ndonjë veprim juridik për kthimin e pronës dhe posedimin e pronës kontestuese për të cilin shkak është dashur që të pranohet revizioni i të paditurës si i bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i gjykatave të instancës më të ulët dhe të refuzohet kërkesëpadija e paditësit.”

17. Parashtruesi i kërkesës, pas zgjidhjes së rastit me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 338/2008, të 6 tetorit 2008, dhe para marrjes së vendimit në lidhje me mjetin e jashtëzakonshëm juridik për mbrojtjen e ligjshmërisë nga Gjykata Supreme e Kosovës, e ka shitur pronën në fjalë, ashtu që tani është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme nën emrin e blerësit Agron Rexhep Morina.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. Nr. 2/2009, të 5 prillit 2011, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese si në vijim:

“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc.nr. 2/2009 të 05.04.2011 të shpallet i paligjshëm dhe të më mundësohet mbrojtja e të drejtës në pronë e përcaktuar me nenin 46 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

21. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
22. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi KEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se si dhe në ç'mënyrë neni 46 pika 1 i Kushtetutës mbështetë kërkesën e tij, siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

23. Në këtë rast parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Gjykatës Komunale në Rahovec, Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëd mënyre kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
24. Në lidhje me ankesën e parashtruesit për shkeljen e pretenduar të nenit 46 të Kushtetutës, mbrojtja e pronës, Gjykata vëren se kjo vlen vetëm për pronën ekzistuese të personave.
25. Prandaj, shpresa se mund të kthehet e drejta në pronën e humbur prej kohësh, nuk mund të konsiderohet si “posedim” e as kërkesë e kushtëzuar e cila është vjetruar si pasojë e mospërmblidhjes së kushteve (shih *Gratzinger dhe Gratzingerova* kundër Republikës Çeke (vendimi)) [VK], nr. 39794/ 98, pasusi 69, KEDNJ 2002-VII).
26. Megjithatë, në rrethana të caktuara “pritja legjitime” për përvetësimin e “pasurive” mund të gëzojë gjithashtu mbrojtjen nga neni 1 të Protokollit 1. Prandaj, në rastet kur interesi pronësor në esencën e padisë, mund të konsiderohet që personi ka “pritje të ligjshme” përderisa ekziston bazë e mjaftueshme e interesimit në ligjin vendor, për shembull kur ekziston praktika e themeluar gjyqësore e gjykatave vendore me të cilën vërtetohet ekzistimi i së njëjtës (shih *Kopecky* kundër Sllovakisë [VK], nr. 44912/98, pasus 52, GJEDNJ 2004-IX). Megjithatë, nuk mund të thuhet se pritshmëria legjitime paraqitet në rastet kur ekziston një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e drejtë dhe zbatimin e ligjit vendor kurse, kërkesat e parashtruesit i hedhin poshtë gjykatat vendore më vonë (shih *Kopecky*, i cituar më lartë, pasusi 50).
27. Gjykata vëren se në rastin konkret ekziston mosmarrëveshje në zbatimin dhe interpretimin e drejtë të ligjit të zbatueshëm dhe që Gjykata Supreme rrjedhimisht ka refuzuar kërkesat e parashtruesit të kërkesës.
28. Përfundimisht, në këtë kërkesë nuk janë përmbushur kushtet për pranueshmëri. Ai nuk ka arritur të mbështesë me fakte se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara kushtetuese.
29. Nga kjo del se, kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, që parashikon se “*Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese*”.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani